



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 239/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Drenas, paraqitur kundër Iniciativës Qytetare për Drenas (IQD), për shkak të vendosjes së posterave mbi posterat e PDK –së, në Drenas, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega Drenas, kështu që Iniciativës Qytetare për Drenas (IQD) i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 10.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga PDK, në të cilën theksohet se në mbrëmjen e datës 09.10.2013 rreth orës 23:30 i kanë vendosur posterat e tyre mbi posterat e PDK-së, që kanë qenë të vendosura në dy lokacione në vendin e quajtur te “Rrethi” dhe te “Tregu i Gjelbër” të cilët anëtarët e PDK-së i kanë vendosur më datë 03.10.2013, ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës është shkelur rregulla e fushatës zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik IQD, me datën 11.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 11.10.2013 në ora 17:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga IQD, në të cilën theksohet se subjekti politik IQD pas marrjes së njoftimit për paraqitjen e kësaj ankesë që na është bërë nga ana e subjektit politik PDK, e kemi shqyrtuar me kujdes ankesën dhe e konsiderojmë si të pabazuar në fakte me efekte negative për prishjen e klimës zgjedhore, dhe nga fotografit si dëshmi të bashkangjitur ankesës nuk mund të konsiderohen si fakte të bazuara sepse duhet të identifikohen kryesit e kësaj vepre se në çfarë lidhje qëndrojnë me subjektin e atakuar në ankesë. Subjekti politik IQD në përgjigjen e ofruar ka theksuar se personat e inkriminuar në mbulimin e posterëve të kandidatëve të PDK-së nuk janë aktivistë të subjektit politik IQD. Subjekti politik IQD potencon se distancohen nga veprimet e tilla të personave apo ndonjë grupi të papërgjegjshëm. Në përgjigjen në ankesë subjekti politik IQD sqaron se kanë ofruar dëshmi për ekzistimin e veprimeve të personave të papërgjegjshëm për mbulimin e posterëve edhe të IQD-së, me posterët e kandidatëve të PDK-së.

Bashkangjitur më përgjigjen në ankesë IQD, ka dërguar fotot për të cilat thuhet se kanë larguar posterat kontestuese, të cilat nuk janë bërë nga aktivistët e tyre dhe unë personalisht i kam hjekur ato dhe kërkoj falje publike për këtë që ka ndodhë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

## Ankesa është e bazuar

Sipas parashtruesit të ankesës, IQD me datën 09.10.2013, në vendin e quajtur te “Rrethi” dhe te “Tregu i Gjelbër” aktivistë të këtij subjekti politik kanë vendosur posterat e tyre mbi posterat e PDK-së, ku me këtë veprim kanë shkelur dispozitat ligjore mbi Zgjedhjet Lokale, neni 33 pika a) dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe

- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografitë e ofruara si provë, nga parashtruesi i ankesës, të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se posterat e subjektit politik PDK janë të mbuluara me posterat e IQD-së, të cilin veprim PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

PZAP-i, duke pas parasysh edhe rrethanat lehtësuese se subjekti politik IQD për herë të parë kandidon në zgjedhje dhe pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë fotografit nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e IQD-së është shkelur neni 4.1 pika a) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe neni 33 pika a) të LZP-së, pasi që posterat e subjektit politik PDK janë dëmtuar dhe janë mbuluar me posterat e subjektit politik IQD, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik IQD, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 239/2013 më datën 17.10.2013.

Kryesuesi i Panelit  
**Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*